Kronikë

Shkodër/ Pas sherrit me pronarin mori kallashnikovin dhe shkoi përsëri në lokal, arrestohet 54-vjeçari (EMRI)

Një 54-vjeçar është arrestuar nga Policia e Shkodrës pas një konflikti me pronarin e një lokali dhe disa persona të tjerë në lagjen "Manush Alimani"

Kallashnikov i sekuestruar nga Policia

Redaksia
22 Shkurt, 14:47 | **Përditesimi: 22 Shkurt, 14:59**

Share

Shkodër-Një 54-vjeçar është arrestuar nga Policia e Shkodrës pas një konflikti me pronarin e një lokali dhe disa persona të tjerë në lagjen "Manush Alimani".

Vedat Hoxha, pas sherrit u rikthye prapë në lokal, por këtë herë me kallashnikov me vete.

Uniformat blu kanë mbërritur në atë moment duke neutralizuar 54-vjeçarin i cili në pamundësi për tu larguar ka hedhur armën në tokë.

LEXO EDHE:
Magjia e karnavaleve në Shkodër tërheq qindra vizitorë nga e gjithë Shqipëria e Mali i Zi! Paradë me maska veneciane dhe kostume shumëngjyrëshe! Report Tv sjell PAMJET

> *"Në kuadër të operacionit policor të koduar "Reagimi", u bë arrestimi në flagrancë për veprat penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit" dhe "Kanosje", i shtetasit Vedat Hoxha, 54 vjeç, banues në Shkodër.*
>
> *54-vjeçari, pas një konflikti me pronarin e lokalit shtetasin G. H., 36 vjeç, ishte larguar duke u rikthyer në lokal ku kishte me vete një armë zjarri kallashnikov. Në momentin që është rikthyer në lokal kanë mbërritur dhe shërbimet e Policisë të cilët kanë ndërhyrë për të neutralizuar 54 vjeçarin që mbante armën e zjarrit në dorë", informoi sot policia.*

Blutë gjithashtu informojnë se do të hetohet në gjendje të lirë pronari i lokalit.

> *"Në vijim të veprimeve u procedua në gjendje të lire shtetasi G. H., 36 vjeç, banues në Shkodër për veprat penale "Punësimi i paligjshëm" dhe "Fshehja e të ardhurave", thuhet më tej në njoftimin e policisë.*

Arma e zjarrit dhe municioni luftarak u sekuestruan si provë materiale.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë së Shkodër, për veprime të mëtejshme.

Xh.K/Shqiptarja.com

TAG: Shkodër | Vedat Hoxha | kallashnikov

Komento

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.COM

Sondazhi i ditës:
Primaret në PD, a mendoni se do të jetë një proces i drejtë?

20 Shkurt, 10:37

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Karnavalet e Shkodrës, spektakël ngjyrash dhe dritash në "Paradën e karrove"! Beci: Vizitorë nga e gjithë Shqipëria dhe ngjyra feste si askund tjetër (VIDEO)
22 Shkurt, 20:34

Rama inspekton punimet në rrugën e Komanit: Ata që ua premtuan, dinë me rrejt! Punime edhe në argjinaturën e lumit Seman
22 Shkurt, 11:30

SKEDA/ Saga e hakmarrjes së përgjakshme Bajri-Lici që nga 2018! Si nisi me një moto-bombë, 12 vrarë dhe 2 të zhdukur në shtatë vite
21 Shkurt, 16:07

SKEDA/ Safet Bajri, dosje voluminoze dhe seri krimesh të dyshuara, por me dënime të pakta! Një nga krerët e grupit, Belgjika e dënoi 2 herë
21 Shkurt, 15:39

RENEA arreston Safet Bajrin, masë sigurie edhe për krahun e djathtë, Astmer Bilali e kushëririn Behar Bajri! SPAK: Ekzekutuan Fatbardh Licin në 2018, morën hak për vrasjen e ish-policit Bërçana (VIDEO)

Sokol Dema

21 Shkurt, 12:46

Thomas Brdaric para AF Elbasanit: Ndeshja e fundit 'më vret', i lumtur për Balajn
20 Shkurt, 11:37

Traditë, ngjyra dhe argëtim, Shkodra fantastike ju pret për Karnavale! Aty do të gjeni dhe gatimet tradicionale të Mrizit të Zanave

Ergys Kavaja

20 Shkurt, 11:13

Berat/ Përzienin produkte të dëmshme dhe i shisnin si vaj ulliri, në kërkim burrë e grua, sekuestrohen 300 litra përzierje lëndësh
20 Shkurt, 10:55

Topalli: Misteri i Ervis Martinajt s'do zgjidhet ndonjëherë, Bajri-Prendi sherr për drogën e humbur, interes për 'Matrix'! Petraj: Skaner grupeve kriminale
19 Shkurt, 19:47

Korçë, fëmijët gjejnë kallash në zonën e stadiumit, ishte mbështjellë me qese
19 Shkurt, 17:49

Zbardhet përplasja me armë në Bushat në gusht të 2024, arrest në burg për Samuel Troshanin dhe Izmir Sakicën! SPAK: Shkuan për të vrarë Prendin e familjarët e tij
19 Shkurt, 14:07

Shkodër/ Tentoi të vriste bashkëjetuesen më pas vrau veten, çifti kishte debate dy javët e fundit! Anila kërkoi ndarjen, Kolë Manaj nuk pranoi! Flet drejtuesja e shoqatës

Ergys Kavaja

19 Shkurt, 12:53

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje